



**Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë:
 Ju uron gëzuar muajin e Madhneshëm të Ramazanit**

Bota / Fq 4 / Kriza në Myanmar (Burma) Përplasjet e budistëve me muslimanët

Nga Tomas FULER

RAJON / Fq 7 / Në përkujtim të gjenocidit në Srebrenicë

Nga Faik MIFTARI

Analiza / Fq 5 / Kriza në Siri dhe tensionimi i mëtejshëm i saj

Nga Bledar KOMINI

Deklaratë / Fq 2 / Qëndrimi islam në lidhje me varret murale dhe zhvarrosjen e eshtrave

Fq 6 / Agjërimi i Ramazanit

Rregulla dhe Dispozita

*Përgatitën: Mustafa TËRNIQI
 dhe Ervin QYLAFKU*

Editorial

FILLIMI...

Sa herë që kujtojmë apo përmendim fillimin e diçkaje menjëherë na vijnë në mendje shprehjet e urta të popullit si: “Fillimi i mbarë gjysma e punës” apo “Dita e mbarë duket që në mëngjes”. Aq shumë është e lidhur mbarësia e diçkaje me zanafillën e saj, saqë është e vështirë të gesh diçka të mirë në këtë botë që fillimi i saj të mos jetë i tillë, edhe pse nuk përjashtohen rastet kur historia flet ndryshe.

Fillimi i çdo pune e ka edhe një fund dhe jo domosdoshmërisht gjërat mbyllet ashtu siç ato nisin, por ajo që na tregon përvoja dhe historia njerëzore duket se është pikërisht mungesa e ruajtjes së vijueshmërisë mbi të cilën nis filli i diçkaje ajo që sjell edhe transformimin e fundit të saj. Jo pa qëllim Feja Islame e sheh mbarësinë e një pune që në fillimet e saj, në botën e ideve dhe qëllimeve, sepse që aty mbin fara e mirësisë ose ligësisë. Pikërisht duke kuptuar rëndësinë vendimtare të kësaj gjëje të parët e mirë të këtij umeti i jepnin përparësi mbi gjithçka nijetit. Për këtë dhe nuk është habi tek lexon thënie të tilla, si “nëse do të kisha shkruar një libër, çdo kapitull të tij do ta kisha nisur me hadithin e nijetit”. Fjalë të tilla duket se më shumë se lexuesit të librit do t'i shërbenin vetë shkruarit të tij, si një rikujtim i pandalshëm i qëllimit që kaq shumë ndryshon, pambarimisht.

Farat e shëndosha të pemëve të bekuara, edhe nëse nuk ushqehen mirë dhe rriten të dobëta në një truall të varfër e armiqësor ato kurrë nuk mund të prodhojnë fryte të hidhura për njerëzit. Edhe pse ushqimi që një pemë merr, formon përmbajtjen dhe tulin e frytit ai përsëri në emër, në formë dhe në shije ngelet fara e tij. Veprat e çdo njeriu në këtë botë lidhen pazgjidhshmërisht pikërisht me atë farë të padukshme që mbin brenda shpirtit të tij. Ajo shpesh është aq e padukshme, saqë mund të bëhet edhe e pakuptueshme për vetë njeriun. Pikërisht për këtë dhe atij i duhet të rremojë pandalshëm nën këtë tokë pjellore të ndjenjave për të parë nëse fara që ai mbolli është po ajo, apo vallë frytet që ai sheh janë produkt i një fare tjetër, që përzihen harlisur me ato të farës së parë? Edhe njëherë këtu të kujtohen fjalët e arta të atyre njerëzve që mbollën dhe korrën mirësi tek thoshin: “gjëja që më së shumti më duhej të kujdesesha për të ishte nijeti, sepse ai vazhdimisht ndryshonte”.

Qëndrimi islam në lidhje me varret murale dhe zhvarrosjen e eshtrave



Editorial

Nijeti, kjo farë e dobët dhe e brishtë si vetë bota ku ajo lind, është një rrezatim i padukshëm drite, një shkëndijë që askush nuk e sheh, por që frytet e saj fizike mund të ndryshojnë botën; a nuk është bota e sotme pikërisht produkti i këtyre fillesave të vogla? E Ai, që është vetë mirësia dhe mbarësia, në duart e të Cilit është fillimi dhe fundi i çdo gjëje, për të na mësuar pikërisht fillimet, na jep një shembull të përkryer të shëmbëlltyrës sonë: “Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqs fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t’ua vënë veshin. Fjala e keqe është si pema e keqe me rrënjë të shkullura, e pa-qëndrueshme për ekzistencë.” (Ibrahim: 24-26)

Me këtë farë në zemër nis edhe gazeta jonë “LIDHJA”, e cila më shumë sesa emri i një organizate simbolizon qëllimin për të cilin ajo u krijua. Qëllimi i sinqertë i saj është të bëhet një mjet që do t’i lidhë muslimanët më shumë me Krijuesin e tyre, me fenë dhe kënaqësinë e Tij, me rregullat dhe normat e kësaj feje, me njohjen e hallallit dhe haramit, e për pasojë edhe me njëri-tjetrin, t’i lidhë besimtarët me atë çka i vlen më së shumti në të dyja botët.

Çdo vepër njerëzore është e mangët dhe për më tepër në fillimet e saj, ndaj për këtë shkak e shkaqe të tjera të jashtme dhe të brendshme të arrish të kënaqësh këdo në këtë botë është një pikësynim i paarritshëm. Në një terren të egër të mbushur me thashetheme, paragjykime dhe skepticizëm, për të mbijetuar dhe për të rritur një pemë të shëndetshme nga një farë e mbarë duhet patjetër të kapërcesh në një kohë jo të shkurtër vështirësi pafund, të cilat shpesh të rrezikojnë edhe jetën. E lusim Allahun që këtë farë mbi të gjitha ta ruaj nga e liga e vetvetes.

Bordi Drejtues

Së pari, sipas normave të fesë Islame, çdo njeri që vdes duhet të varroset në tokë dhe kjo konsiderohet një ritual respekti ndaj tij. Allahu duke treguar se si u varros njeriu i parë në këtë tokë, thotë: “Allahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t’i treguar se si ta mbulonte kufomën e të vëllait.” (Maide: 30-31) Së dyti, norma e përgjithshme islame, për sa i përket të vdekurve, është se ata nuk duhet të zhvarrosen asnjëherë, por të lihen ashtu, derisa trupi të tretet dhe kockat të shpërbëhen tërësisht. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: “Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?” (Jasin: 78). Fjala remind e përdorur në ajetin kuranor, flet për kockat që kalben tërësisht dhe bëhen dhe’. Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: “Prej tokës ju kemi krijuar, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.” (Ta Ha: 55) Kjo do të thotë se njeriu si qenie e krijuar nga dheu, duhet të qëndrojë në të pasi të vdesë, derisa të zhduket plotësisht e të bëhet dhe’. Duke u bazuar në sa u tha më lart, çdo njeri ka të drejtë të ketë banesën e tij të fundit në këtë botë të përkohshme, përpara se ai të ringjallet, e që është varri i tij personal.

Kjo, sipas normave islame do të thotë se: a) Nuk lejohet të varrosen dy të vdekur në të njëjtin varr, vetëm se atëherë kur i vdekuri i parë të jetë tretur plotësisht, aq sa dhe kockat t’i jenë bërë pluhur. Për këtë, juristët islam të shkollës juridike islame hanefi, shkollë të cilën e ndjek zyrtarisht edhe Komuniteti Musliman i Shqipërisë, shprehen se: “Nëse një i vdekur varroset në një varr, ku është varrosur më parë dikush tjetër, kjo duhet të bëhet pasi të jenë zhdukur eshtrat e të parit dhe të mos ketë mbetur asgjë prej tij. Por, nëse shihet se eshtrat e të vdekurit të parë ekzistojnë akoma, atëherë duhet të mbulohen sërish me dhe’, duke mos i lëvizur ato.” Juristët e kësaj shkollë islame kanë theksuar se “Vetëm kur i vdekuri i parë të jetë bërë tërësisht dhe’, lejohet të varroset një tjetër në të njëjtin varr, por nuk lejohet në asnjë mënyrë thyerja e kockave dhe as zhvendosja e tyre në një vend tjetër.” Të njëjtin mendim ndajnë edhe juristët e tri shkollave të tjera islame, ata shafi, maliki dhe hanbeli. Pra, ka një konsensus në mes juristëve të shkollave të ndryshme juridike islame, se është e ndaluar kategorikisht

(haram), që të zhvarroset një njeri nga varri, nëse për këtë nuk paraqitet një nevojë e domosdoshme, e konsiderueshme nga normat fetare islame, sepse një akt i tillë cenon shenjtërinë e të vdekurit. b) Lejohet në rast domosdoshmërie kur nuk ka vend, ose tokë të lirë, që i vdekuri të varroset në një varr ku është varrosur dikush tjetër para tij, të cilit nuk i janë tretur kockat, por duke respektuar në këtë rast disa norma të veçanta. Juristët islam janë shprehur se në rastet kur është e pamundur të gjendet tokë tjetër për të varrosur të vdekurit, mundet që për shkak të kësaj domosdoshmërie, i vdekuri të varroset bashkë me një tjetër në të njëjtin varr. Pra, nuk lejohet që të nxirren jashtë eshtrat e atij që është varrosur më parë dhe të zhvendosen në vend tjetër, për të varrosur një njeri tjetër në të. Juristët e shkollës hanefi janë të mendimit se “I vdekuri i dytë mund të varroset afër të parit, duke lënë mes të dyve një kufi prej dheu.” Asnjë nga juristët e shkollave juridike islame, nuk lejon që eshtrat e të vdekurit të parë të nxirren nga varri, për të futur një tjetër në të, sepse varri është banesë personale e tij, dhe këtë të drejtë askush nuk mund t’ia marrë atij. Por, në rast domosdoshmërie, varri mund të bëhet banesë për dy vetë, përndryshe uzurpimi i banesës, qoftë te të gjallët, qoftë te të vdekurit, është i ndaluar. Së treti, nuk lejohet që eshtrat e të vdekurit të nxirren nga varri dhe të murosen, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të drejtpërdrejta të normativës islame të përmendur më sipër. Veç kësaj, një veprim i tillë përbën shkelje të hapur të urdhërësës së Profetit Muhamed (paqja e Zotit qoftë mbi të) që ndalon ngritjen dhe lartësimin e varreve, si dhe përfshihet nga ndalesa e imitimit të riteve zakonore të komuniteteve të tjera. Së katërti, nuk ka asnjë afat të caktuar kohor se kur lejohet zhvarrimi apo prishja e varreve dhe riciklimi i eshtrave, qoftë ky 33, 40, apo 60 vjet. Të gjitha opinionet që jepen në këtë drejtim janë individuale, të pabaza dhe s’kanë kurrfarë argumenti fetar. Siç e përmendëm më sipër, afati i përcaktuar nga juristët islam është tretja e plotë e eshtrave, dhe natyrisht, që kjo ndryshon nga një vend në tjetrin dhe varet nga shumë faktorë. Së pesti, nuk lejohet përdhosja e varreve dhe dëmtimi i kufomave, sepse Profeti i Islamit ka

ndaluar që varri të shkelet me këmbë, dhe gjithashtu ka thënë: “Thyerja e kockave të të vdekurit, është si thyerja e kockave të të gjallit.” Së fundi, Ne nuk mendojmë se gjendemi në një situatë domosdoshmërie e cila për më tepër do të na detyronte të mos respektonim normat e fesë tonë, por në respekt të këtyre normave fetare ne kërkojmë: Mundësimin e hapësirave të veçanta për varrosjen e besimtarëve muslimanë, ashtu siç ka qenë traditë në këtë vend, para ardhjes së regjimit ateistokomunist, kërkesë kjo e bërë që nga koha e H. Sabri Koçit, kryetar i parë i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, pas ndryshimit të sistemit të dikurshëm. Po ashtu, si rrugëzgjdhje të përshtatshme të këtij problemi, ne shohim edhe hapjen e varrezave private, dhe për përmbushjen e kësaj gjëje, ne i kërkojmë institucioneve shtetërore krijimin e lehtësirave ligjore dhe procedurale, në mënyrë që ne si besimtarë të kemi mundësi të respektojmë normat fetare të varrimit në përputhje me besimit tonë. Me këtë rast, iu bëjmë thirrje besimtarëve muslimanë që të bashkëpunojmë dhe të kontribuojmë së bashku, për të gjetur rrugët e zgjidhjes së këtij problemi, qoftë edhe duke kontribuar financiarisht në blerjen e vendeve të përshtatshme për hapjen e varrezave, ku respektohen normat e fesë islame për këtë gjë.

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë

PUNA NE ORGANET E DREJTESISË

Nr. 65

Asambleja e Juristëve Muslimanë të Amerikës

Zoti i ka dërguar Profetët e Tij dhe i ka zbritur Librat që njerëzit të gjykojnë me drejtësi. Rruga që ata duhet të ndjekin për t’ia arritur këtij qëllimi është të gjykojnë me ligjet e Tij, sepse këto ligje mbartin drejtësinë e plotë, dhe për këtë njerëzit duhet të lënë mënjatë çdo ligj që bie në kundërshtim me ligjet e Zotit, ligje që janë hartuar sipas dëshirës dhe rrethave njerëzore. Nuk lejohet të drejtohesh për gjykim në gjykatat joislame, vetëm në rastet kur nuk ka organizëm tjetër të pranuar fetarisht, e që është i aftë të kthejë të drejtat dhe largojë padrejtësitë. Kërkesat në këtë rast kudo që të paraqiten duhet të jenë të drejta fetarisht, në këtë rast duhet të pranohen vetëm gjykimet që përputhen me fenë, nëse dikush fiton nga gjykimi diçka që nuk i takon, atëherë ai nuk duhet ta marrë atë, sepse vendimi që jep gjykatësi nuk e bën haramin hallall dhe as hallallin haram, ai është thjeshtë zbulues i gjykimit dhe jo ai që e vendos atë që në themel.

Pakicat islame duhet të përpiqen të shuajnë konfliktet e tyre brenda kornizave të gjykimin islam dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet, duke ndjekur rrugët ligjore të vendeve ku ata jetojnë, të mundësojnë vënien në praktikë të gjykimeve islame, në veçanti në gjykimet që kanë të bëjnë me kodin civil.

Puna në fushën e avokatisë është e lejuar, nëse avokati është i bindur se çështja që ai mbron është e drejtë dhe e lejuar fetarisht.

Ekonomi/Financë

Bankat Islame nuk e njohin krizën

Asete në rritje në gjashtë muajt e fundit me 20% dhe kanë mbërritur 500 miliardë kapitale. Po rritet në Evropë numri i bankave që respektojnë principet uranore, dhe pikërisht në momentin kur bota financiare perëndimore është përgjurmur nga efektet e krizës së kredive subprime (njihen edhe si kredi të këqija), ndërkohë që financa islame po demonstroi kështu një vitalitet të paprecedent.

Nëse në vitin 2007 u emetuan 206 bonde për gati 47 miliardë dollarë nga këto institute, në 2008 kjo shifër u rrit me tej me 10 miliardë. Këtë gjë na e nxjerr në pah revista mujore "World & Pleasure", e cila i është përkushtuar botës së biznesit dhe luksit, e cila deklaroi se obligacionet dhe fondet besnike ndaj principeve kuranore janë duke u rritur në mënyrë eksponenciale. Obligacionet islame të emëtuara sukuk po rriten dita ditës. Bondi i parë u emetua në vitin 1990, i dyti 10 vite më pas në vitin 2000. Atë vit u realizuan 3 emisione për një total 366 milionë dollarësh. Tre vite më pas u rritën në 37, për një shumë prej 5,7 miliardësh, dhe në 2006 u emetuan 199 bonde për një vlerë 27,17 miliardësh, të cilat u rritën në 2007 në kuotën 206 me një total 47 miliardë dollarësh. Në tremestrin e parë të 2008 u emetuan 44 bonde për 2,3 miliardë. Por përtej vëllimit të transaksioneve ajo që po konstatohet edhe më sy të lirë është edhe rritja e numrit të bankave islame, vëren "World & Pleasure". Deri edhe National Bank of Kuwait një nga më të mëdhatë në Lindjen e Mesme ka shpallur projektin e saj për të hapur një bankë islame në Zvicër

në partneritet me një institucion audit. Në Shtetin Helvetik ekzistojnë tashmë dy banka të tjera islame, që i shtohen 4 prej tyre në Britaninë e Madhe dhe 5 të tjera vepruese në SHBA. E ndërsa përhapen në Perëndim bankat islame janë në rritje edhe në Vendet Arabe. Perspektivat e rritjes të financës me bazë shariatit vlerësohen mbi 15% në vit, dyfishi në krahasim me ato të financave tradicionale. Kjo sepse në këtë 5-vjeçar bankimi islam duhet të rregullohet uniformisht në të gjithë zonën e euros, kështu një kanal i ri evropian do të hapet për financën ndërkombëtare, duke krijuar kështu një rol kyç në raportet ndërmjet institucioneve financiare islame dhe ato perëndimore. Dhe numrat e këtij fenomeni financiaro-fetar flasin vetë. Ashtu siç e ka nxjerrë në pah "World & Pleasure" 1,400 miliardë dollarë është shifra e vlerësuar në 2010 e kapitaleve administrative nga shërbimet financiare, që kujdesen mbi zbatimin e rregullave kuranore mbi menaxhimin e kapitaleve dhe 300 miliardë dollarëve të kapitalizimit vjetor të Bursës me tituj konform Sheriatit në tregjet e letrave me vlerë të Vendeve Islame. Dhe jo vetëm. Janë 70 treguesit aksionerë të përpiluar mbi bazën e kompatibilitetit me normat kuranore dhe 300 institucionet financiare të pranishme në 65 vende, që ndjekin rregullat e Sheriatit. Por kush janë rregullat e financave islame? Instrumentet financiare sipas shariatit janë produkte që nuk parashikojnë pagesat me Riba (interesa-kamatë), dhe i përjashtojnë sjelljet ekonomike me Gharar (dyshime të paarsyetuara), Maisir (spekullime) dhe

Haram (ajo që është e ndaluar në mënyrë të shprehur në Kuran). Rregullat përsillen të gjitha rreth ndalimit të Ribasë, e ndaluar sepse nuk mund të ketë fitim të sigurt a priori dhe pa pasur asnjë rrezik: kështu ndahen të mirat e përfituara nga investimi i përbashkët. E ndaluar është Gharari, term që tregon se nuk mund të krijosh avantazh nga mungesa e informacionit të tjetrit, dhe gjithashtu është e ndaluar të lidhësh një kontratë, duke e lidhur me ngjarje të panjohura. Në financën kompatibël


me Sheriatin nxitet shumë marrëveshja Mudareba, një lloj sipërmarrjeje kapitaliste, ku ai që fut kapitalin ndërmerr rrezikun e humbjes, nëse punët shkojnë keq, dhe kush merr pjesë me punën ndërmerr rrezikun të punojë pa fitim. Përjashtohet këtu rreziku i përfundimit i mbytur në borxhe.

<http://www.ilsol24ore.com/art/SoleOnline4/Mondo/2009/01/finanza-islamica.shtml?uuid=1d6602d8-dfec-11dd-9949-b0cfd0c5e1df>



**Supported through a partner solution.

Amnesty International konstaton paragjykimet anti-muslimane në Evropë



Grupi i të drejtave të njeriut Amnesty International thotë se Muslimanët që e shpallin hapur fenë e tyre vuajnë gjerësisht nga diskriminimi në Evropë.

Në një raport të ri ky grup i nxit Qeveritë Evropiane të përpiqen më shumë për të sfiduar stereotipet dhe paragjykimet negative kundër muslimanëve. Në veçanti ky raport vëren se Muslimanët ballafaqohen me përjashtimin nga puna dhe arsimit përdorin forma tradicionale

veshjeje. Ai kritikon edhe ndalimin e velit të fytyrës për gruan në disa shtete. "Grave Muslimane iu janë mohuar vendet e punës dhe vajzat janë parandaluar të shkojnë në klasat e zakonshme, vetëm sepse ato veshin forma tradicionale të veshjes, të tilla si Mbulesa e Kokës. Burrat mund të shkarkohen nga detyra pse kanë mjekra që mund të lidhen me Islamin"- thotë specialisti i diskriminimit për këtë grup Mario Perolini. "Në vend që t'i luftojnë këto paragjykimet partitë politike dhe zyrtarët publikë shumë shpesh i lënë pas dore këto gjëra, për t'i shfrytëzuar në kërkim të votave."

LIRIA E SHPREHJES

Raporti thekson lëvizjet e fundit në Belgjikë, Hollandë, Francë e Spanjë për të ndaluar mbulimin me vel të të gjithë fytyrës të përdorur nga disa gra muslimane, po aq sa edhe ndalimin e minareve të ndërmarrë në Zvicër. Ai gjithashtu kritikon rregullat në shumë vende, që i ndalojnë studentet të mbajnë Mbulesën e Kokës, apo veshje të tjera tradicionale ose fetare në shkollë.

"Të përdorësh veshje fetare apo veshje simbolike kulturore është pjesë e të drejtave të Lirisë së Shprehjes. Është pjesë e të drejtës të Lirisë së Religjionit apo të Besimit - dhe të gjitha këto të drejta duhet t'i gëzojnë të gjitha fetë njësoj."- thotë z. Perolini.

Sipas këtij grupi të të drejtave ndalimi i mbulimit të plotë me vel i fytyrës nuk mund të justifikohet me çështjet e sigurisë, përveç se në rrethana të caktuara, si të tilla si kontrolli i sigurisë apo në zonat me rrezik të lartë. Ndërsa duartrokin dëshirën për të ndaluar gruan për të qenë e detyruar t'i përdori veshje fetare apo tradicionale, raporti thotë se kjo nuk duhet të arrihet duke i ndaluar individualisht gratë nga përdorimi i disa lloje veshjesh. Amnesty International gjithashtu akuzon Belgjikën, Francën dhe Hollandën, se kanë dështuar në zbatimin e ligjeve të përshatshme për ndalimin e diskriminimit në punësim.

Ky raport thotë se nëpunësit janë lejuar të diskriminojnë në vendet e tyre të punës ato simbole fetare apo kulturore, që hyjnë në konflikt me klientët, kolegët apo me imazhin e kompanisë. Duke cituar statistika që tregojnë nivele të ulëta punësimi (në Evropë) ndërmjet emigrantëve femra nga Vendet Muslimane, raporti thotë se vëzhgimet mbi Gratë Muslimane na sugjerojnë, se kjo i fajëson pjesërisht për diskriminimin ato. Rekomandimet e raportit përfshijnë krijimin e një trupe kombëtare anti-diskriminimi dhe përpjekje më të mëdha për të monitoruar diskriminimin mbi baza fetare.

<http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-17824132>

PUNA NE FUSHEN
IMOBILIAREVE DHE RASTET
KUR PERZIHET HALLALLI ME
HARAMIN
Nr. 67
Asambleja e Juristëve Muslimanë të
Amerikës

Norma bazë për sa i përket punës si sekser është lejimi, përderisa aktivitetet për të cilat ndërmjetësohet janë të lejuara. Nuk u lejohe kompanive imobiliare dhe as individëve që punojnë si sekser, të ndërmjetësojnë në shitjen e objekteve që dihet me siguri ose me hamendjen me të madhe se përdoren për aktivitetet të ndaluara fetarisht. Nëse një punonjësi musliman, i ngarkohet si detyrë nga këto kompani ndërmjetësimi për nënshkrimin e një kontrate, për të cilën ai është i sigurt ose ka hamendjen më të madhe se ka veprimtari të ndaluar fetarisht dhe ai nuk i shmanget dot kësaj pune, ndërkohë që pjesa më e madhe e punës së kësaj kompanie është e lejuar, atëherë tolerohet që ai ta bëjë këtë punë në rast nevojë si dhe për faktin se këto raste të kompanisë ku ai punon janë të rralla, por gjithsesi duhet të ketë gjithmonë parasysh që duhet të ruhet nga ndalesat apo t'i pakësojë ato sa të mundet.

Lejohet që kompanitë imobiliare ose individët që punojnë si sekser të nënshkruajnë një kontratë shitjeje edhe nëse blerësi e ka siguruar koston e saj nëpërmjet kredive me interes bankar. S'ka ndonjë ndalesë që kjo gjë të shkruhet në kontratë, por nuk lejohet që sekseri të marrë pjesë në lehtësimin e procedurave të marrjes së kredisë bankare, qoftë kjo duke treguar se cilët janë ata që i japin këto kredi bankare me interes apo duke plotësuar formularët e këtyre bankave.

Bota

Kriza në Myanmar (Burma)

Përplasjet e budistëve me muslimanët

Nga Tomas FULER



Bangkok – Myanmar ka deklaruar gjendjen e jashtëzakonshme në një nga shtetet e tij perëndimore, ku u vranë të paktën 17 persona muajin e fundit në dhunën e shpërthyer ndërmjet budistëve dhe muslimanëve. Dhuna ngren një tjetër pengesë për qeverinë e presidentit Thein Sein, ndërsa ai po përpiqet ta hapi vendin pas vitesh të tëra izolimi nga junta ushtarake dhe ta orientojë atë drejt demokracisë. Usharët dhe policia po përpiqen të rivendosin rendin në fshatrat e shtetit të Rakhinit, ku pas përplasjeve të dhunshme ka pasur shumë të plagosur dhe janë djegur 500 shtëpi vetëm brenda dy ditëve. Thein Sein, një ish-gjeneral, lajmëroi gjendjen e jashtëzakonshme në fillim të muajit. Ai nuk u tregua i qartë për pasojat që do të sjelli gjendja e jashtëzakonshme; policia dhe ushtria në Myanmar, që njihet edhe si Burma, zotërojnë akoma një pjesë të madhe të fuqisë megjithëse vendi ka lëvizur drejt demokracisë. Presidenti Thein Sein e ka kthyer si prioritetin e tij kryesor pajtimin kombëtar ndërmjet shumicës burmase me grupimet e tjera etnike. Por tensionet pranë kufirit me Bangladeshin dalin jashtë qëllimit të përpjekjeve për pajtim kombëtar, sepse aty përfshihen popullsi nga një grupim etnik musliman, Rohingya, pjesëtarët e të cilit qeveria nuk i njeh si qytetarë të vet. Tensionet në këtë zonë janë rritur që prej muajsh, thotë Kris Leva, një ekspert i Rohingyave, që është një nga mbrojtësit e kauzës së tyre. Qeveria e Myanmarit nuk ka propozuar ndonjë zgjidhje për 800.000 Rohingya, të cilët jetojnë në kushte të dëshpëruara nëpër kampe refugjatësh dhe i bëjnë ata një nga grupimet etnike më të mëdha në Azi, që nuk kanë shtet. Brenda Myanmarit frikësohen, se këto përplasje mund të zgjerohen në një konflikt më të gjerë fetar. Këto ditët e fundit grupe të vogla Budistësh e Muslimanësh kanë protestuar veç e veç në qytetin kryesor të Myanmarit, Jangon. Në një shënim me tone shumë të nxehta në uebsitin e Eleven Media Group, një nga publikuesit e një gazete të përjavshme të rëndësishme u shfaqën një varg komentesh urrejtje-nxitëse ndaj Muslimanëve nga lexuesit e saj. “Terroristi është terrorist”, shkruante një lexues, i cili nënshkroi me emrin Maungpho. “Vetëm vritini ato”.

Ko Ko Gyi, një ish-i dënuar politik, që po ndihmon në përpjekjet për të

lehtësuar tensionet fetare, tha se ai ishte i habitur “nga përgjigjet emocionale” ndaj këtyre përplasjeve. “Neve na duhet të qetësohemi dhe të gjejmë një zgjidhje intelektuale këtij problemi,”- tha ai. Udhëheqësit Muslimanë kanë bërë thirrje për qetësi dhe Lidhja Kombëtare për Demokraci, partia e laureatit të çmimit Nobel Dau Aung San Su Kyi lëshoi një deklaratë, ku i bënte thirrje qeverisë për të rivendosur rendin. Përreth 90% e popullsisë në Myanmar është budiste, ndërsa muslimanët përbëjnë gati 4%. Tani për tani qeveria duket se ka besimin, që mund t’i përmbajë përplasjet. “Nuk duket se do të përhapet kjo gjë,”- thotë Ting Maun Than, presidenti i një organizate kërkimore në Jangon, i cili është një nga ndihmësit kryesorë të qeverisë në bisedimet me grupet e tjera etnike. “Bashkësia Muslimane brenda vetë Burmës ka një përvojë të gjatë bashkëjetese me shumicën Budiste”. Në këtë vend tejet të varfër Rohingya të shumica e të cilëve jetojnë që prej disa

brezave janë minoriteti më i lënduar, nga ajo që Kombet e Bashkuara e kanë cilësuar “krizë kronike”. Ata nuk lejohen të kenë tokën e tyre, vuajnë nga mungesa e ushqimit dhe teknikisht ata nuk mund të udhëtojnë jashtë Rakhinit, i cili është në kufi me Bangladeshin. Me mijëra prej tyre janë larguar nga vendi me varka vitet e fundit për të kërkuar punë në Malajzi dhe vendet përreth. Gjithashtu ka disa qindra mijëra Rohingya në anën tjetër të kufirit, Bangladeshin. Çështja Rohingya nxit një përgjigje me baza të forta nacionaliste deri edhe ndërmjet anëtarëve më liberalë të shoqërisë burmase. Ko Ko Gyi, që ka kaluar 18 vite në burg si kundërshtar i ish-juntës ushtarake, thotë se Rohingya nuk është nga ato nacionalitete të pranueshme në vend, dhe që

“Komuniteti Ndërkombëtar” duhet të gjejë një zgjidhje problemit të tyre të mungesës së shtetësisë. Kjo është një çështje e sovranitetit kombëtar, thotë ai. Kushdo që do të marrë qytetarinë e Myanmarit i duhet të mësojë njërën nga gjuhët kombëtare të Myanmarit dhe të mësojë për kulturën tonë”. Një vëzhgim i OKB-së në Myanmar në qershor 2008 nxori në pah se më tepër se gjysma e Rohingyave janë analfabetë. Nuk ka ndonjë vështirësi të madhe, se çfarë përbëjnë Rohingya. Muslimanët që jetojnë në pjesën më veriore të Shtetit të Rakhinit në përgjithësi quhen Rohingya pavarësisht prejardhjes së tyre. Zyrarë qeveritarë i referohen atyre si Bengali.

<http://www.nytimes.com/2012/06/11/world/asia/state-of-emergency-declared-in-western-myanmar.html>

Burma ka një popullatë prej 75 milion banorësh, në përbërje të së cilëve bëjnë pjesë rreth 4 % muslimanë. Muslimanët e Burmës ku shumica e tyre quhen Rohingya, janë ballafaquar me probleme qysh prej vitit 1962, kur ushtria e këtij vendi mori pushtetin mbi këtë shtet të Azisë Juglindore. Në dhunën disa dekadëshe mbi muslimanët e këtij vendi, më shumë se 500 fshatra muslimanë janë djegur, mijëra prej tyre janë shfarosur, që kur erdhi ushtria në pushtet. Persekutimi i muslimanëve burmas nuk ka të ndalur edhe sot e kësaj dite. Përkundër këtij gjenocidi, të gjitha organizatat për të drejtat e njeriut po heshtin, thotë Muhamed Talha për albtimë në lidhje me këtë situatë. Sipas disa statistikave numri i viktimave nga ana e muslimanëve është marramendës.



Analiza

Kriza në Siri dhe tensionimi i mëtejshëm i saj

Nga Bledar KOMINI

“NATO nuk ka si qëllin ndërhyrjen ushtarake në Siri...” Këto ishin fjalët e Sekretarit të përgjithshëm të NATO-s Anders Fogh Rasmussen dhënë në një konferencë për shtyp para pak ditësh. Kriza siriane, për të cilën komuniteti ndërkombëtar po ndjen “keqardhje” do të vazhdojë edhe më tej. Fakti që aleanca më e madhe ushtarake sot në botë, e drejtuar prej vendeve më demokratike dhe mbështetëse të lirisë dhe të drejtave të njeriut, nuk pranon të ndërhyjë në një krizë me përmasa të mëdha si ajo e Sirisë, tregon se kriza do të ketë amplituda të larta e në përshkallëzim të mëtejshëm.

Ekzistenca e një Lidhje Arabe të përcarë dhe të paafte për të marrë një vendim për të ndërhyrë në krizën siriane, është treguesi më i mirë se rajoni po përjeton krizën më të thellë të dekadave të fundit. Komisarja e Lartë e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Navi Pillay, në informimin që i bëri Këshillit të Sigurimit mbi krizën në Siri, bëri apel për dërgimin e kësaj të fundit në Gjykatën Ndërkombëtare Penale. Pillay tha se forcat e regjimit të Asadit kanë kryer krime serioze kundër civilëve, duke theksuar se ekzistojnë prova të shumta që vërtetojnë se në veçanti forcat e varura nga regjimi kanë kryer krime kundër njerëzimit.

Raporti vjetor i Freedom House e ka përcaktuar vitin 2012 si “Më i keqi i më të këqinjve”. Raporti thotë se regjimet autokratike mbetën ende të fuqishme dhe të shperndara në të katër anët e botës. Një në katër njerëz sot në botë jeton në shtete të në të cilat dhunohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe që drejtohen nga diktatura prej dekadash dhe megjithatë – thuhet në raport – ndryshimi mund të jetë i mundshëm edhe për këto shoqëri. Numri i shteteve diktatoriale ka rënë gjatë viteve të fundit dhe në disa shtete të tjera ekzistojnë premiset për të fituar lirinë e për t’u bashkuar me vendet demokratike. Nëntë janë shtetet e përcaktuara nga Raporti si “më të këqinjte”, ku renditen Guinea Ekuatoriale, Eritrea, Korea e Veriut, Arabia Saudite, Somalia, Sudani, Siria, Turkmenistani, Uzbekistani, Tibeti dhe Saharaja Perëndimore. Vrasja



e civilëve dhe protestuesve, masakrat e ushtrisë siriane si dhe represioni ndaj grupeve opozitare, kanë bërë që Freedom House ta përfshijë Sirinë në grupin e këtyre shteteve.

Pavarësisht faktit se kriza në Siri përshkallëzohet nga dita në ditë, komuniteti ndërkombëtar vijon të mbetet pasiv dhe të luaj vetëm rolin e negociatorit. Më datë 22 qershor 2012 Siria rrëzoi në hapësirën ajrore ndërkombëtare mbi Mesdheun Lindor një aeroplan zbulues ushtarak tip F-4 të Forcave Ajrore të Turqisë. Ankaraja zyrtare reagoi fuqishëm ndaj këtij sulmi. Autoritetet e shtetit, qeveria dhe partitë opozitare turke nga njëra anë bënë deklaratat të ashpra kundër Sirisë, nga ana tjetër i bënë thirrje shoqërisë ndërkombëtare që të reagojë ndaj sulmit sirian. Këshilli i NATO-s, i mbledhur me kërkesë të Turqisë në kuadër të artikullit

IV të traktatit themelues të organizatës, e dënoi Sirinë dhe e paralajmëroi atë që të mos e përsërisë më një sulm të tillë. Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe disa vende islame gjithashtu deklaruan mbështetjen e tyre për Turqinë kundër aktit armiqësor të Sirisë. Kryeministri turk, Rexhep Tajip Erdoan, veçanërisht gjatë fjalimit që mbajti në mbledhjen e grupit parlamentar të Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP), vuri në pah se Turqia nuk do të bëjë lëshime për këtë ngjarje, s’do të ketë aspak tolerancë dhe do të ashpësohet akoma më shumë, Ankaraja ndryshoi rregullat e angazhimit të Forcave të Armatosura të Turqisë kundër Sirisë dhe se kështu do të vihej në shënjestër e qëllonjë çdo mjet ushtarak, që do të vinte nga Siria.

Ajo që është më qesharaka në këtë mes, është fakti se tekta e tërë bota është fokusuar në krizën siriane, Presidenti sirian Bashar al-Assad për të justifikuar dhunën e ushtruar ndaj civilëve dhe masakrat masive, ka miratuar një sërë ligjesh kundër terrorizmit. Parlamenti sirian ratifikoi tri ligje që gjykojnë me dënim të rëndë personat, të cilët kryejnë akte “terroriste” për të ndryshuar natyrën e regjimit. Sipas akteve të ratifikuara personat të cilët formojnë, udhëheqin apo janë anëtarë në një grup terrorist rrezikojnë nga 10 deri në 20 vjet punë të detyrueshme, por dënimi mund të jetë edhe më i rëndë nëse qëllimi është ndryshimi i regjimit.


Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara prej muajsh nuk ka mundur të marrë dot ndonjë masë ndaj regjimit të Bashar al-Assadit. Kina dhe Rusia vazhdojnë të jenë mbështetëset më të mëdha të regjimit. Ndërsa SHBA-ës vazhdojnë të shprehin mbështetjen e tyre tek Kofi Anan, si negociator për zgjidhjen e krizës. Siria, e inkurajuar nga mbështetja që Rusia dhe Kina i ofron

udhëheqjes së Asadit, i ka shtuar gjithnjë e më shumë sulmet e saj të dhunshme. Ndërsa opozitarët sirianë, bazuar në përkrahjen që marrin nga disa aktorë ndërkombëtarë e rajonal, vazhduan t’u bëjnë ballë sulmeve të dhunshme dhe të përgjakura në arritje drejt Damaskut. Por është tepër e vështirë dhe ende herët të flitet për një sukses serioz të opozitës.

Realisht problemi i Sirisë është edhe emri i një polarizimi, që po zhvillohet në rajon dhe botë, sepse aktualisht është rritur edhe tensionimi ndërmjet vendeve si Rusia, Kina dhe Irani, të cilat përkrahin Bashar al-Assadin, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, Lidhjes Arabe dhe Turqisë, që mbështesin opozitarët sirianë. Kjo ndarje në kampe të ndryshme deri tani ishte kryesisht në formën e një polarizimi politiko-diplomatik. Dhe pikërisht për shkak të këtij polarizimi nuk kanë pasur sukses as nismat e disa shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për gjetjen dhe vendosjen e paqes. Si shembull për këtë mund të japim “Planin e Paqes” së Kofi Ananit, i cili mbeti pa rezultat për shkak se regjimi i Asadit dhe vendet përkrahëse të tij nuk e mbështetën plotësisht.

Pyetjet që shtrohen mbeten ende ato të ditëve të para kur kriza sapo kishte filluar: A do të ketë një ndërhyrje ndërkombëtare në Siri, sic u vepra edhe me Libinë e Gadafit? A do ta njohin ndërkombëtarët opozitën siriane dhe kërkesat që ata ngrejnë? Cili do të jetë qëndrimi i SHBA-e pas zgjedhjeve presidenciale ose pas ardhjes së një presidenti të ri në drejtim? Edhe për sa kohë do të vazhdojnë të mbështesin regjimin në Siri, Kina dhe Rusia, kur ato e dinë se kështu po ulin reputacionin e tyre në rajon?

<http://njihvetveten.wordpress.com/2012/07/09/kriza-ne-siri-dhe-tensionimi-i-metejshem-i-saj/>



Agjërimi i Ramazanit

Rregulla dhe Dispozita

Përgatitën: Mustafa TËRNIQI
dhe Ervin QYLAFKU



Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Allahut të Lartësuar, Zotit të botëve. Paqja dhe bekimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin, dhe mbi të gjithë ata të cilët ndjekin rrugën e tij deri në ditën e fundit.

Të agjërosh do të thotë të privohesh nga ushqimi, pija, marrëdhëniet seksuale dhe nga të gjitha shkaqet e tjera që e prishin agjërimin, duke filluar nga agimi (imsaku) e deri në përfundimin e diellit, me qëllim adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut.

Agjërimi i muajit Ramazan është një detyrim islam dhe një nga pesë shtyllat kryesore të tij. Agjërimi ka qenë detyrim edhe për besimtarë të tjerë para nesh, të cilëve u janë dërguar Profetë. Allahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar, agjërimi u është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe për ata që ishin para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm.”** (El Bekare: 183)

Agjërimi i muajit Ramazan është bërë detyrim për muslimanët në vitin e dytë të hixhretit (emigrimit). Për vlerat e mëdha të këtij muaji dhe të agjërimin të tij, Profeti Muhamed (alejhi selam)ka thënë: **“Ju ka ardhur një muaj i bekuar, në të cilin është bërë detyrim agjërimi. Në këtë muaj janë hapur dyert e Xhenetit, janë mbyllur dyert e Xhehenemit dhe shejtanët janë lidhur në pranga. Në të gjendet një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj.”** (Ahmedi & Nesaiu)

ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN

1. Të ngrënë dhe të pirët me qëllim:

Kush ha ose pi me harresë ose është i detyruar, nuk e ka prishur agjërimin dhe nuk e ka detyrë ta kompensojë. Profeti (alejhi selam)thotë: **“Kush harron në agjërim dhe ha e pi, le ta vazhdojë agjërimin se atë e ka ushqyer Allahu i Lartësuar.”** (Buhariu & Muslimi)

2. Marrëdhëniet seksuale: Ai që kryen marrëdhënie seksuale duke e ditur

se është agjërueshëm dhe duke e ditur se ato e prishin agjërimin, ai duhet të agjërojë një ditë tjetër si shlyerje pas Ramazanit, plus edhe dy muaj rresht si dënim për nënvleftësimin ndaj këtij muaji të shenjtë. Këto dy muaj duhet të agjërohen ditë pas dite, rresht, pa shkëputje. Kjo vlen vetëm për prishjen e agjërimin me marrëdhënie seksuale. Ebu Hurejra thotë: **“Erdhi një burrë tek Profeti (alejhi selam)dhe i tha: “U shkatërrova, o i Dërguari Allahu!” Profeti e pyet: “Cila gjë të shkatërroi?” Ai u përgjigj: “Kreva marrëdhënie gjatë agjërimin të Ramazanit.” Profeti i tha: “A mund të lërosh një rob?” Ai i tha: “Jo.” Profeti i tha: “A mund të agjërosh dy muaj rresht?” Ai i tha: “Jo.” Profeti i tha: “A mund të ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?” Burri i tha jo dhe u ul. Në këtë moment Profeti i sollën një shportë të madhe me hurma³. Profeti ia dha këtë enë atij burrit që i erdhi dhe i tha: “Merre këtë shportë dhe shpërndajua të varfërve.” Burri ia ktheu: “A ka më të varfër se unë?! Nuk gjen ndërmjet dy skajeve të Medinës familje më nevojtare sesa e imja.” Atëherë Profeti qeshi aq sa iu dukën dhëmballët dhe tha: **“Shko dhe ushqe me të familjen tënde.”** (Buhariu & Muslimi)**

3. Provokimi i të vjellit: Kur kjo ndodh pa qëllim, atëherë agjërimi është i saktë. Profeti (alejhi selam)ka thënë: **“Kush vjell pa e provokuar, nuk e ka prishur agjërimin dhe kush e provokon atë, le të agjërojë një ditë kaza.”** Ky është mendimi unanimit i të gjithë dijetarëve. (Ahmedi & Ebu Davudi)

4. Dalja e gjakut te femra për arsye menstruale apo të lindjes, edhe në qoftë se kjo ndodh pak çaste para se të përfundojë dielli. Për këtë pikë dijetarët islamë janë të një mendimi.

5. Ejakulimi, nga çdo lloj epshi, qoftë edhe kur nuk kryhen marrëdhënie seksuale, si për shembull ejakulimi nga ngacmimet vetjake apo të huaja, fërkimet,

puthjet etj. Nëse ejakulimi vjen si pasojë e sëmundjes, gjumit apo rrëzimit, kjo gjë nuk e prish agjërimin. Gjithashtu ai nuk prishet me shikimin e një gjëje eksituese ose me mendim, edhe në qoftë se kjo zgjat për një periudhë të gjatë kohe. Këtu futet edhe dalja e spermatores (lëng i tejdukshëm që del para daljes së spermës nga eksitimi) apo sekrecioni i prostatit (lëng i trashë që del me urinën).

Allahu i madhëruar në një hadith kudsij thotë: **“Ai (agjëruesi) të ngrënë, të pirët dhe epshin e tij e lë për Mua. Agjërimi është për Mua dhe Unë shpërblej për të.”** (Buhariu & Ebu Davudi)

6. Marrja e ilaçeve nga goja apo e çdo gjëje tjetër, si për shembull kokrra e drithit ose orizi të pagatuara, guralecë, shkop, gjëra të dëmshme e të padëmshme, me kusht që ta kalojnë fytyrën dhe nëse kjo bëhet me vetëdije dhe duke e ditur se është agjërueshëm.

7. Kush e bën nijet të prishë agjërimin gjatë tij, e ka prishur atë edhe nëse nuk ka futur gjë në gojë. Kjo sepse nijeti është kusht për agjërimin

8. Futja e ujit në bark gjatë abdesit pa dashje nga neglizhenca. Shumica e dijetarëve janë të mendimit se ai që merr abdest dhe e kalon ujin e tij në bark jo nga harresa, por nga pakujdesia e momentit, ai e ka prishur atë ditë dhe duhet ta zëvendësojë më vonë. Kjo bazohet në hadithin e Profetit a.s, i cili thotë: **“Kur të shpëlësh hundën (në abdest), çoje ujin sa më lart, përveçse kur je me agjërim.”** (Ebu Davudi & Tirmidhiu) Imam Ebu Hanife, Maliku dhe Shafiu janë të mendimit se kjo e prish agjërimin, përndryshe Profeti (alejhi selam)nuk do ta ndalonte çuarjen e ujit sa më lart gjatë agjërimin.

9. Pirja e duhanit. Dijetarët bashkëkohorë të fikut, kanë rënë dakord se pirja e duhanit futet tek ato gjëra të cilat e prishin agjërimin. Në lidhje me këtë çështje, ata kanë dhënë argumente të shumta

ÇFARË NUK E PRISH AGJËRIMIN

1. Të ngrënë, të pirët dhe marrëdhëniet seksuale me harresë: Profeti (alejhi selam)thotë: **“Kush harron gjatë agjërimin dhe ha ose pi diçka, le ta vazhdojë agjërimin sepse atë e ka ushqyer Allahu i Lartësuar.”** (Buhariu & Muslimi)

2. Të vjellët pa provokim: Kjo bazohet në hadithin e përmendur më lart.

3. Futja e pluhurit, grimcave të rërës apo e ndonjë insekti pa dashje në stomak: Dihet që është shumë e vështirë që njeriu të ruhet prej këtyre gjërave. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: **“Dhe nuk ju ka bërë ju vështirësi në fe.”** Gjithashtu në këtë logjikë futet edhe mbajtja e ndonjë sendi në gojë, si laps, gomë apo ndonjë gjë tjetër, por me kusht që të mos ketë shije, ngjyrë apo erë që arrin në fyt.

4. Përdorimi i misvakut nuk e prish agjërimin: Profeti (alejhi selam)e ka përdorur atë dhe ka thënë: **“Misvaku është pastrues për gojën dhe kënaqësi për Allahun.”** (Nesaiu & Ibën Huzejme)

5. Përdorimi i gjilpërave joushqyese për trupin, të cilat vendosen në damar ose në mish: Kjo gjë nuk e prish agjërimin për arsye sepse nuk konsiderohet si ushqyes për trupin. Në këtë pjesë si shembull mund të përmendim kurimin me ilaçe mbi plagë të ndryshme, edhe në qoftë se ilaçi arrin të depërtojë në brendësi të trupit. Nuk duhet harruar se transfuzioni i gjakut dhe serumi e prishin agjërimin, pasi janë ushqyese për trupin e njeriut.

6. Përcjellja e pështymës ose e ushqimit që ndodhet ndërmjet dhëmbëve, nëse është shumë pak.

7. Futja e ujit në gojë, me kusht që të mos shkojë në fyt: Kjo ndodh kur marrim abdest apo kur shpëlajmë gojën për shkak të vapës. Lejohet gjithashtu edhe larja e trupit për freskim etj., se Profeti alejhi salatu ue selam e ka lagur kokën e tij gjatë agjërimin nga etja ose vapa, siç transmetohet nga Ahmedi dhe Ebu Davudi.

8. Puthja e gruas, prekja, përqaftimi etj. Kjo vlen për ato raste kur njeriu e kontrollon veten. Aishja r.a. thotë: **“Profeti (alejhi selam)ka puthur gjatë agjërimin dhe ka qëndruar në intimitet, por ishte më i vetëpërmbyturi ndaj epshit të tij krahasuar me ju.”** (Ahmedi)

9. Ai që ha, pi ose bën diçka tjetër nga ato gjëra që e prishin agjërimin me mendim se akoma nuk ka filluar dita e agjërimin. Ky person nuk e ka prishur agjërimin, pasi origjina është vazhdimi i natës dhe dyshimi i tij nuk merret në konsideratë.

10. Provimi i shijes së ushqimit me majën e gjuhës nuk e prish atë.

11. Larja e dhëmbëve, me kusht që pasta e dhëmbëve mos ta kalojë fytyrën.

12. Shkulja e dhëmbëve ose kurimi i tyre, në qoftë se lëndët e përdorura nga mjeku nuk arrijnë në fyt.

RAJON

Në përkujtim të gjenocidit në Srebrenicë

Nga Faik MIFTARI

Edhe sivjet më 11 korrik 2012, u përkujtua për të 17 vit me radhë, tragjedia e Srebrenicës, me akademi dhe ceremoniale të shumta për nder të mbi 8000 viktimave të rëna, dhe me këtë rast u varrosën edhe mbetjet mortore të 510 viktimave të gjetura dhe të identifikuara gjatë periudhës prej 11 korrikut 2011 e gjer më 11 korrik 2012.

Srebrenica, qytet në Bosnjën lindore, është i vetmi vend në Evropë në të cilin është kryer gjenocidi më i madh pas Luftës së Dytë Botërore e gjer më sot. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me seli në Hagë e ka sjell vendimin mbi gjenocidin e kryer në Srebrenicë me datë 27 shkurt 2007.

Agresori serbomadhi në dhe rreth Srebrenicës, në korrik të vitit 1995, për vetëm një javë ka pushkatuar, likuiduar dhe vrarë mbi 8000 boshnjakë të kapur, të zënë rob, apo të dorëzuar, qindra prej tyre i ka propozuar për së gjalli, ka prerë dhe sakatosur, ka mbytur bile edhe fëmijë të porsalindur para syve të nënës, ka dhunuar gra dhe vajza boshnjake, dhe ka depërtuar me forcë mbi 30.000 gra dhe fëmijë që ishin të strehuar gjatë katër viteve të luftës, në Tuzell, që me një fjalë të përmbledhur lirisht, ka realizuar skenat e "Ferrit të Dantes".

Në Beograd më 15 korrik 1995, kohë gjatë së cilës forcat militare dhe paramilitare serbe ishin duke kryer gjenocidin mbi myslimanët boshnjakë, tek Slobodan Millosheviçi, lideri serbomadhi, i cili vdiq në burgun e Shveningenit në Hagë, u mbajt një takim sekret, në të cilin kanë marrë pjesë, Karl Bildti (përfaqësues i Bashkimit Evropian për Bosnjën në atë kohë), Torvald Stoltenbergu (përfaqësues i Kombeve të Bashkuara për Bosnjën), Jasushi Akashi (përfaqësues special i sekretarit gjeneral të Kombeve të Bashkuara), Rupert Smith (komandant i forcave paqeruajtëse të UNPROF-orit të Kombeve të Bashkuara në Bosnjë), si dhe me kërkesë të Karl Bildtit mysafiri special, gjenerali gjakatar serb Ratko Mlladiçi, i cili ka qenë realizues dhe zbatues të urdhërit politik të liderit serb Radovan Karaxhiç, për kryerjen e gjenocidit në Srebrenicë.

Gjenocidi në Srebrenicë i kryer ndaj boshnjakëve mysliman, në një zonë sigurie të vënë në mbrojtje nga Kombet e Bashkuara, është bërë para syve të opinionit botëror, me asistimin dhe pacifizmin e treguar jashtë çdo logjike njerëzore, të forcave të Kombeve të Bashkuara (batalionit holandez), i cili ka pasur për detyrë të bëjë mbrojtjen e zonës së sigurisë së Srebrenicës, po për fat të keq i tradhtoi dhe i la në mëshirë të çetnikëve serb, me urdhër të liderëve politikë dhe ushtarakë

shtetëror botëror, si dhe ndalimin e sulmeve ajrore mbi caqet serbe, të cilët do të parandalonin dhe pamundësonin gjenocidin e kryer në Srebrenicë, para syve të mbarë opinionit botëror.

Gjenocidi ndaj hebrejve është kryer gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa gjenocidi ndaj boshnjakëve në Bosnjë e Hercegovinë, është kryer 50 vite pas procesit të mbajtur të Nurenbergut, për dënimin e të dyshuarve nazistë për gjenocid dhe krim të luftës, kur është dhënë deklarata e famshme: "Kurrë më!". Por kjo "Kurrë më" ndodhi në Srebrenicë 50 vite pas, dhe pikërisht nën dijeninë e Kombeve të Bashkuara.

Për të kuptuar më mirë shkakun e gjenocidit të kryer në Srebrenicë, do të citoj shkrimtarin boshnjak Alija Isakoviç në "Antologjinë e së keqes", i cili përveç të tjerash thotë: "Për të kuptuar këtë së pari duhet lexuar të gjitha veprat shkencore të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (SANU), edhe veprat shkencore nga fizika, astronomia, arti, muzika... Të gjitha! ..."

Nuk çudit tani fakti, se kryetari i porsazgjedhur serb Tomislav Nikolliç, pas zgjedhjes deklaroi: "Se nuk ka pasur gjenocid në Srebrenicë", kur të njëjtën gjë e deklaroi edhe gjenerali francez Morillon duke thënë: "Se në Srebrenicë nuk pasur gjenocid, dhe se serbët nuk kanë se çfarë të turpërohen".

Këtu nuk mund të mos e citoj edhe publicisten e njohur boshnjake Fahira Fejziç, e cila në një analizë të shkëlqyer, bërë dy librave të botuara kohë më parë, përveç tjerash shkruan: "Në rast se ky gjenocid i kryer në Srebrenicë është vetëm një në vargun e gjenocideve të ardhshme që planifikohen, për të zgjidhur definitivisht të ashtuquajtur "Çështjen Lindore" të pjesës së dikurshme evropiane të Perandorisë Osmane, gjegjësisht të Ballkanit të sotshëm, që ajo që nuk është kryer gjatë shekullit XX, definitivisht të kryhet gjatë shekullit XXI. Në këtë konkluzion kam ardhur duke marrë për bazë dy libra të lexuara të dy autorëve të ndryshëm, të dy periudhave të ndryshme kohore." Është fjala për librin e autorit amerikan Justin Mc Carthy "Death and exile, the ethnic cleansing of Othoman Muslims", 1821-1922, Darwin, 2004, USA., në të cilin në mënyrë precize flet për procesin e përhershëm të spastrimit etnik të myslimanëve otoman, term me të cilin i quan autori myslimanët që kanë jetuar dhe vazhdimisht janë zhdukur nga hapësirat e dikurshme të Perandorisë Osmane evropiane, duke u nisur nga Bosnja, Sanxhaku (Serbi e Mali i Zi), Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Rumani etj. Autori amerikan cek se



ky trend humbës njëshekullor i territoreve dhe spastrimeve nga myslimanët po zgjerohet në mënyrë tendencioze për të përfunduar gjatë shekullit XXI. Shekull, në të cilin edhe Evropa Jugore do të duhet të pastrohet nga jo të krishterët, kësaj here nga myslimanët, gjë që në një mënyrë janë vërtetuar me ngjarjet e ndodhura para, gjatë dhe pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, si dhe në agresionin serbomadhi të kryer gjatë viteve 90 të shekullit XX, veçanërisht në Bosnjë dhe në Kosovë, që ka rezultuar me vrasjen dhe dëbimin të një numri shumë të madh të myslimanëve të Ballkanit.

Libri i dytë është i autorit boshnjak Fikret Karçiç me titull: "Muslimanët e Ballkanit, Çështja Lindore në shekullin XX", Tuzla, 2004, BeH. Evropa është hapësirë krishtere, në veri-perëndim katolike-protestante, në juglindje ortodokse, dhe nuk toleron bashkëjetesën multifetare në hapësirat e veta. Evropa katolike-protestante punën e vet të spastrimit të hebrejve e ka kryer gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa Evropa ortodokse ka dashur ta kryejë spastrimin e myslimanëve gjer në fund të shekullit XX. Pasi spastrimi i duhur nuk është kryer si duhet, njëherit kjo punë duhet përfunduar, me thënien" sa më parë aq më mirë". Kjo nuk është çudi, se në një të ardhme të afërt do të mund të përsëritej para syve të botës, spastrimi i myslimanëve, e sidomos para syve të Evropës me prezencën e kamerave televizive, dhe të mos i pengojë fare të fuqishmit e botës, sikurse kanë bërë gjer tani".

Këtë brengë në mënyrën më të qartë e ka ilustruar publicisti i njohur kroat Željko

Milićević në analizën e tij me titull "Sot djalli e ka vrarë dhe djeg Perëndeshën e drejtësisë" pas verdiktit të dhënë të Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë me 27 shkurt 2007 me ç'rast Serbinë e liroi nga akuza për gjenocid në Bosnjë e Hercegovinë, i cili analizën e tij e përfundon me fjalët: "Unë, si i krishterë që jam, pas kësaj mendoj se posedimi i armatimit nuklear dhe gatismëria që në çdo kohë të përdoret vetëm për qëllimet mbrojtëse, është i vetmi garant i mbrojtjes së vazhdueshme dhe i ekzistimit të boshnjakëve në veçanti dhe myslimanëve në përgjithësi në Ballkan". Do ta përmbyllja këtë përkujtim të gjenocidit të Srebrenicës, me një rëfzim të tmerrshëm të boshnjakes Xhemile Zekiç, dëshmitare e gjallë e gjenocidit të kryer në Srebrenicë:

"Qëndroja në mes popullit të dëshpëruar e të grumbulluar në Potoçare të Srebrenicës, kur çfarë të shoh, gruaja e re, është shtrënguar, djersët i rridhnin në ballë, ngërç në fytyrë të saj. Iu afrova dhe e pyeta çfarë ka, ajo më tha, po lind, po bijë i thashë, mbahu me një dorë për mua, e me tjetrën për vjehrrën,... Ashtu u bë, u shtrëngua gruaja e re në ne..., u ndie vaji i foshnjës djalë. E mora foshnjën dhe po dua t'ia lidhi këthizën, kur çetniku serb doli para meje duke më thënë: lëshoje këtë foshnje në tokë. Unë e lëshova dalëngadalë në dimitë e mia, foshnja e bukur me flokë të gjata, sikur të ishte larë, tani,... çetniku serb iu afrova, dhe këmbën e tij e nguli në fytyrë e njomë të foshnjës së porsalindur,... zorrët e njoma iu shkapërderdhën në të gjitha anët..."





PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!

Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el -Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

**Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë xhamisë
"Dine Hoxha", Tiranë**

Cel: 0672812607 / 0672821589

Tefsir Kurani SADI

Autor:

Abdur-rahman ibnu Nahir El Sadi
Vëllimi I (El Fatiha – El Maide)

Përktheu: Uthman Agolli

Boton: Lidhja e Hoxhallarëve
të Shqipërisë

Tiranë: qershor 2012

612 faqe

Dijetarët, që nga kohët e para e deri më sot i kanë dhënë një rëndësi shumë të madhe tefsirit të Kur'anit. Ndër ata që janë marë me tefsirin e Kur'anit famëlartë, është edhe shejh Abdur-rahman ibnu Nahir El Sadij, Allahu e mëshiroftë. Ai është prej dijetarëve të njohur të kohëve të fundit. Ndër cilësitë e këtij tefsiri mund të përmendim se ai nuk është i tejjgjatur dhe as tepër i shkurtuar. Ai është i mbushur me dobi të shumta dhe përfshin në vetvete mësimë shumë të vyera në shumë fusha; në fushën e akides, moralit, ligjeve dhe dispozitave të përfutuara nga ajetet etj, etj. Shejh Abdullah ibnu Abdulaziz ibnu Akil, i cili gjithashtu ka qenë një ndër nxënësit e shejhut, duke folur për këtë tefsir ka thënë: "Ky tefsir është sjellë me shprehje



të qarta dhe të thjeshta, lehtësisht i kuptueshëm dhe i renditur shumë bukur. Ai përpiket që të qartësojë kuptimin e ajetit me fjalë të pakta të përmbledhura dhe shumë të thella në kuptimet që përmbajnë. Fjalë të pakta, por me kuptime të shumta dhe dobi të shumta. Ai është përpjekur të sjellë çdo dobi, kumt dhe gjykim që përmbajnë ajetet, qoftë nga kuptimet e drejtpërdrejta e të dukshme qoftë nga ato të kuptuara nga ajetet, pa u tejjgjatur dhe pa u shpërndarë larg subjektit që shtjellon.

Komenti i sures Kehf

Autor: Muhamed bin Salih
el-Uthejmin

Përshtati: Altin Plumbi


Botim privat

Tiranë: qershor 2012

150 faqe

Ky është një koment Kurani i Këbërë nga dijetari i famshëm arab bashkëkohor Uthejmin. Sureja Kehf ka zbritur në Meke dhe i përket periudhës së parë, ku edhe trajtohen kryesisht çështjet e besimit në Zotin Një. Ky koment është i ndërtuar në bazë të tematikës që trajton kjo sure, por janë dhënë shpjegime edhe për kuptimet gramatikore të tij vende-vende.

Disa prej temave të trajtuara në komentin e kësaj sureje janë: Historia e djemve të Shpellës; Shprehja inshallah; Historia e dy fqinjëve dhe e kopshteve të tyre; Shprehja "mashallah la kuete ila bilah"; Historia e Musait me Hizrin dhe Historia e Dhulkarnejnit. Historia e djemve të Shpellës dhe Historia e



Musait me Hizrin janë dy nga temat më interesante dhe të shtjelluara me kujdes nga komentuesi, po ashtu edhe temat e tjera paraqesin shumë interes për lexuesin, sepse sjellin një mendim të kualifikuar shkencor në disiplinën e tefsirit nga Shejh Uthejmini. Shpjegimet e dhëna janë të thjeshta dhe të kuptueshme, si dhe janë sjellë me një gjuhë të pastër nga përkthyesi.